



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

DRAFT PLANI I BUXHETIT KOMUNAL I KLINËS

2025-2027

Korrik / 2024

Tabela 1: Financimi komunal për vitet 2025-2027 sipas burimit

Korniza afatmesme buxhetore 2025-2027	Buxheti aktual 2024	Planifikimi 2025	Vlerësimi 2026	Vlerësimi 2027
Granti i përgjithshëm	6,086,118.00	6,571,819.00	6,951,325.00	7,337,752.00
Granti specifik i arsimit	5,453,127.00	5,953,349.00	6,131,950.00	6,315,908.00
Granti i shëndetësisë	1,673,212.00	1,897,981.00	1,988,325.00	2,082,970.00
Të hyrat vetanake	1,436,260.00	1,495,504.00	1,606,855.00	1,720,536.00
Financimi për shërbimet rezidenciale		250,000.00	200,000.00	200,000.00
Totali :	14,648,717.00	16,168,653.00	16,878,455.00	17,657,166.00

BUXHETI I KOMUNËS SË KLINËS SIPAS KATEGORIVE TË SHPENZIMEVE PËR PERIUDHEN 2025 – 2027

Tabela 6. Korniza Buxhetore Komunale, në euro

Përshkrimi	2024	2025 (planifikim)	2026 (vlerësimet)	2027 (vlerësimet)
1 TË HYRAT TOTALE KOMUNALE	14,648,717.00	16,168,653.00	16,878,455.00	17,657,166.00
1 Të hyrat vetanake	1,436,260.00	1,495,504.00	1,606,855.00	1,720,536.00
1 Grantet dhe transferet qeveritare	13,212,457.00	14,673,149.00	15,271,600.00	15,936,630.00
2 SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE	14,648,717.00	16,168,653.00	16,878,455.00	17,657,167.00
2.1 Shpenzimet rrjedhëse	10,496,857.00	11,762,032.00	12,341,744.00	12,960,155.00
Pagat dhe medijtjet	7,936,857.00	8,892,032.00	9,381,094.00	9,878,292.00
Mallrat dhe shërbim	1,710,000.00	1,700,000.00	1,734,000.00	1,768,680.00
Shërbime komunale	250,000.00	370,000.00	386,650.00	405,983.00
Subvencionet	600,000.00	800,000.00	840,000.00	907,200.00
2 Shpenzimet Kapitale	4,151,860.00	4,406,621.00	4,536,711.00	4,697,012.00

Projektet me prioritet për vitin 2025

Emri i projektit		Totali	10	21
1	Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klinës me segmente të tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	330,000.00	250,000.00	80,000.00
2	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësore dhe mbitokësore në Klinë	117,968.00	87,968.00	30,000.00
3	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Klinës	15,000.00	15,000.00	
4	Bashkëfinancim me donatorë	468,653.00	418,653.00	50,000.00
5	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	40,000.00	20,000.00	20,000.00
6	Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	570,000.00	420,000.00	150,000.00
7	Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	35,000.00	20,000.00	15,000.00
8	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Poterq- Dugajevë-Drenovce	120,000.00	90,000.00	30,000.00
9	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	100,000.00	80,000.00	20,000.00
10	Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Klinë-Shtupel-Kërnice	170,000.00	140,000.00	30,000.00
11	Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Grapcë	40,000.00	20,000.00	20,000.00
12	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferke-Qupevë	180,000.00	130,000.00	50,000.00
13	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Cerovik-Qabiq	15,000.00		15,000.00
14	Asfaltimi i rrugëve Ranoc - Leskoc	25,000.00	25,000.00	-
15	Asfaltimi i rrugëve Siqevë-Ujmirë-Shtaricë	35,000.00	15,000.00	20,000.00
16	Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	20,000.00	10,000.00	10,000.00
17	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	90,000.00	70,000.00	20,000.00
18	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogël-Klinavc	40,000.00	20,000.00	20,000.00
19	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100,000.00	80,000.00	20,000.00
20	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë	75,000.00	55,000.00	20,000.00
21	Rregullimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës	5,000.00	-	5,000.00
22	Rregullimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë	5,000.00	-	5,000.00
23	Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lagja Arbëri, Burimi i Jarinës - Pogragjë	70,000.00	50,000.00	20,000.00
24	Ndërtimi i shtigjeve të ecjes dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarinës-Pogragje	20,000.00	10,000.00	10,000.00
25	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Jashanicë-Jelloc-Resnik	150,000.00	120,000.00	30,000.00
26	Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore të rrugës Klinë-Zllakuqan	25,000.00	25,000.00	

27	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	35,000.00	20,000.00	15,000.00
28	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	35,000.00	25,000.00	10,000.00
29	Ndërtimi i infrastruktures nëntokësoredhe mbitokësore Qeskovë-Këpuz-Rastoka	40,000.00	20,000.00	20,000.00
	Urbanizmi	2,971,621.00	2,236,621.00	735,000.00
30	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e sherbime		
31	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	50,000.00	30,000.00	20,000.00
32	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	210,000.00	160,000.00	50,000.00
33	Rindërtimi i infrast mbitok me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videj etj	160,000.00	130,000.00	30,000.00
34	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e sherbime		
35	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e sherbime		
36	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	100,000.00		100,000.00
37	Blerja e kamionit me eskavator për pastrim të ambientit në Klinë	10,000.00		10,000.00
38	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	123,000.00	93,000.00	30,000.00
	Infrastruktura rrugore	653,000.00	413,000.00	240,000.00
39	Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallra e sherbime		
40	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallra e sherbime		
	Inspeksioni	-	-	-
41	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive në Komunën e Klinës	210,000.00	150,000.00	60,000.00
42	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallera e sherbime		
	Arsimi	210,000.00	150,000.00	60,000.00
43	Furnizim me pajisje mjekësore	40,000.00	40,000.00	-
44	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	260,000.00	210,000.00	50,000.00
45	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore	30,000.00	20,000.00	10,000.00
	Shendetësia	330,000.00	270,000.00	60,000.00
46	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve komunale	40,000.00	40,000.00	-
47	Blerja e veturave zyrtare	0.00		
48	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e sherbime		
	Administrata	40,000.00	40,000.00	-
49	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	50,000.00	50,000.00	
	Kultura	50,000.00	50,000.00	-

50	Furnizim me pajisje gjeodezike	12,000.00		12,000.00
	Gjeodezia	12,000.00	-	12,000.00
51	Ndërtimi i kanaleve te ujitjes	140,000.00	100,000.00	40,000.00
	Shtrimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	Mallra e sherbime		
	Bujqesia	140,000.00	100,000.00	40,000.00
	Totali :	4,406,621.00	3,259,621.00	1,147,000.00

Projektet me prioritet për vitin 2026

Emri i projektit	Totali	10	21
1 Rindërtimi i rrugëve te Qytetit te Klimes me segmente te tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	100,000.00	60,000.00	40,000.00
2 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore në Klinë	100,000.00	60,000.00	40,000.00
3 Ndërtimi i rrjetit te ujësjellësit në Komunen e Klinës	30,000.00	30,000.00	
5 Bashkëfinancim me donatorë	768,056.00	708,056.00	60,000.00
6 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	60,000.00	50,000.00	10,000.00
7 Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	288,000.00	188,000.00	100,000.00
8 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Poterqe-Dugajevë-Drenovce	100,000.00	80,000.00	20,000.00
9 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	80,000.00	60,000.00	20,000.00
10 Ndërtimi i rrugëve dhe riparimi i rrugës Klinë-Shtupel-Binxhë	120,000.00	90,000.00	30,000.00
11 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Volljakë-Sferkë-Qupevë	100,000.00	80,000.00	20,000.00
12 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Qabiq-Cerovik	60,000.00	60,000.00	
13 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Leskoc-Ranoc	50,000.00	50,000.00	
14 Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërrnicë-Binxhe-Gracë	50,000.00	40,000.00	10,000.00
15 Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	250,000.00	230,000.00	20,000.00
16 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Ujemir-Shtaricë - Siqevë	50,000.00	50,000.00	
17 Rregullimi i shtratit te lumit Drini i Bardhë	40,000.00	20,000.00	20,000.00
18 Rregullimi i shtratit te lumit Lumëbardhi i Pejes	20,000.00		20,000.00

19	Ndertimi i shtratit të lumit Klina, Lagja Arbëri, Burimi i Jarinës - Pogradjë	250,000.00	150,000.00	100,000.00
20	Ndertimi shtigjeve te ecjes dhe infrastrukture rrugore ne Gryken e Jarines-Pogradje	60,000.00	40,000.00	20,000.00
21	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	100,000.00	50,000.00	50,000.00
22	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	80,000.00	60,000.00	20,000.00
23	Ndertimi i parkut industrial per Kline	10,000.00		10,000.00
24	Ndërtimi i kanalit kullues të ujit nga Gryka e Jarinës - Dersnik - Arbëri	10,000.00		10,000.00
25	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	60,000.00	50,000.00	10,000.00
26	Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Jashanicë-Jelloc-Resnik	90,000.00	60,000.00	30,000.00
27	Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	50,000.00	30,000.00	20,000.00
28	Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	130,000.00	100,000.00	30,000.00
	Urbanizmi	3,106,056.00	2,396,056.00	710,000.00
29	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e sherbime		
30	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara	100,000.00	70,000.00	30,000.00
31	Zgjerimi i rrjetit te ndriçimit publik	193,655.00	143,655.00	50,000.00
32	Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videjë etj	180,000.00	130,000.00	50,000.00
33	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e sherbime		
34	Mirëmbajtja e rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e sherbime		
35	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	180,000.00	130,000.00	50,000.00
36	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës	130,000.00	60,000.00	70,000.00
	Infrastruktura rrugore	783,655.00	533,655.00	250,000.00
37	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallra e sherbime		-
38	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallra e sherbime		
	Inspeksioni	-	-	-
39	Rindërtimi I objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210,000.00	150,000.00	60,000.00
40	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallra e sherbime	-	

	Arsimi	210,000.00	150,000.00	60,000.00
41	Furnizim me pajisje mjekësore	50,000.00	50,000.00	
42	Ndërtimi i shtëpisë për persona të moshuar	20,000.00	20,000.00	
43	Ndërtimi dhe renovimi i objekteve shëndetësore	30,000.00	30,000.00	-
	Shendetësia	100,000.00	100,000.00	-
44	Rindërtimi i objektit komunal në Klinikë	50,000.00	50,000.00	
45	Blerja e veturave zyrtare	35,000.00	35,000.00	
46	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime		
	Administrata	85,000.00	85,000.00	-
47	Furnizim me pajisje gjeodezike	12,000.00		12,000.00
	Gjeodezia	12,000.00	-	12,000.00
48	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	80,000.00	60,000.00	20,000.00
	Kultura	80,000.00	60,000.00	20,000.00
49	Ngritja e serave me participim	Subvencione		
50	Furnizim me fidane të pemëve të imëta: mjedër, dredhëza dhe manaferrë	Subvencione		
51	Ngritja e tufave të dhive me participim	Subvencione		
52	Furnizim me pemë arnore me participim	Subvencione		
53	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes	160,000.00	120,000.00	40,000.00
54	Fondi emergjent			
	Bujqësia	160,000.00	120,000.00	40,000.00
	Totali :	4,536,711.00	3,444,711.00	1,092,000.00

Projektet me prioritet për vitin 2027

Emri i projektit	Totali	10	21
1 Rindërtimi i rrugëve të Qytetit të Klina me segmente të tyre: S Rexhepi, M Daka, F Elezaj, M Haxhaj, L Palucaj, H Prishtina, I Qemajli, F Bojaj etj	220,000.00	120,000.00	100,000.00
2 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Klinë	80,000.00	50,000.00	30,000.00
3 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Cerovik-Qabiq	50,000.00	30,000.00	20,000.00
4 Ndërtimi i rrugëve (Trotuare) dhe infrastruktures nëntokësore në Zajmë-Deiq	90,000.00	60,000.00	30,000.00
5 Ndërtimi i segmenteve të rrugës Mal Bashota, Dositej Obradović, Bekim Fehmiu dhe infrastruktures nëntokësore në Klinë-Dersnik-Dollc	250,000.00	200,000.00	50,000.00
6 Ndërtimi i rrugëve dhe ures në Budisalcë-Rudice	70,000.00	50,000.00	20,000.00
7 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Videje-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe	100,000.00	60,000.00	40,000.00
8 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Vogel-Klinavc	50,000.00	30,000.00	20,000.00
9 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gllarevë-Rixheve-Stapanice-Zabergje	80,000.00	60,000.00	20,000.00
10 Ndërtimi i rrugëve dhe rindërtimi i rrugës Kline-Shtupel-Kërnice	100,000.00	70,000.00	30,000.00
11 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Grabanicë-Bokshiq-Dollove	100,000.00	80,000.00	20,000.00
12 Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Gremnik-Qupevë e Ulët	50,000.00	30,000.00	20,000.00
13 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Jashanicë-Jelloc-Resnik-Pogragjë	100,000.00	50,000.00	50,000.00
14 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Siqevë-Ujmirë-Shtarice	55,000.00	40,000.00	15,000.00
15 Ndërtimi i kanalizimit në Shtupel-Kërnice-Binxhe-Grapce	20,000.00	-	20,000.00
16 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Sferkë-Volljake-Qupeve	80,000.00	60,000.00	20,000.00
17 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Qeskovë-Këpuz	30,000.00	30,000.00	-
18 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Ranoc - Leskoc	25,000.00	25,000.00	-
19 Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Komunën e Klinës	20,000.00		20,000.00
20 Bashkëfinancim me donatorë	1,118,370.00	968,370.00	150,000.00
21 Ndërtimi i liqenit akumulues për furnizim me ujë të pijes	30,000.00	20,000.00	10,000.00
22 Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë	20,000.00	20,000.00	-
23 Ndërtimi i shtratit të lumit Lumëbardhi i Pejës	20,000.00	20,000.00	
24 Ndërtimi i shtratit të lumit Klina, Lgja Arbëri, Burimi i Janrinës - Pogragjë	150,000.00	100,000.00	50,000.00
25 Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhë dhe infrastrukture rrugore në Gryken e Jarines-Pogragjë	45,000.00	20,000.00	25,000.00
26 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore Gjurgjevik i Madhë	50,000.00	50,000.00	
27 Ndërtimi i rrugëve e infrastruktures nëntokësore në Perqevë	20,000.00	20,000.00	
28 Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Zllakuqan-Pataqan-Berkove	70,000.00	50,000.00	20,000.00
29 Asfaltimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore Krusheve e Vogel	45,000.00	45,000.00	-
30 Studimi i fisibilitetit për ndërtimin e ngrohjes qendrore në qytetin e Klina	Mallëra dhe shërbime		
31 Ndërtimi i rrugës Shpella e Azem Bejtes-Përqevë	100,000.00	70,000.00	30,000.00
32 Ndërtimi i rrugëve dhe infrastruktures nëntokësore në Poterqevë-Dugajevë-Drenovce	80,000.00	50,000.00	30,000.00
Urbanizmi	3,318,370.00	2,478,370.00	840,000.00
33 Ndërtimi i kanaleve të ujërave	130,000.00	80,000.00	50,000.00
34 Shtrimi i rrugëve fushore me zhavor dhe pastrimi i rrjedhave ujore	30,000.00	30,000.00	
Furnizim me makinazëm bujqësor për fermerë	Subvencion		


	Ndertimi i serave	Subvencion		
	Bujqesia	160,000.00	110,000.00	50,000.00
	Mirëmbajtja e drunjëve dekorativ në rrugët e qytetit	Mallra e shërbime		
35	Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbruara (Parqeve)	130,000.00	100,000.00	30,000.00
36	Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	130,000.00	100,000.00	30,000.00
37	Rindërtimi i infrast mbitok me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Zllakuqan, Klinë-Videj etj	130,000.00	80,000.00	50,000.00
	Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	Mallra e shërbime		
	Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit te Kamerave te qytetit	Mallra e shërbime		
38	Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujrave të zeza	206,642.00	106,642.00	100,000.00
	Riparimi i kanalizimit ne Komunen e Klines	Mallra e shërbime		
39	Ndërtimi i rrethojave të vorrezave në Komunën e Klinës dhe mirëmbajtja e tyre	130,000.00	100,000.00	30,000.00
	Mirëmbajtja e rrugëve	Mallra e shërbime		
	Infrastruktura rrugore	726,642.00	486,642.00	240,000.00
40	Furnizim me pajisje mjekësore	50,000.00	30,000.00	20,000.00
41	Ndërtimi i shtëpisë për përsona të moshuar	20,000.00	20,000.00	
42	Rindërtimi i objekteve shëndetësore	35,000.00	20,000.00	15,000.00
	Shendetësia	105,000.00	70,000.00	35,000.00
	Shenjzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve	Mallëra dhe shërbime		
	Rrënimi i objekteve te vjetra dhe ndërtimeve pa leje	Mallëra dhe shërbime		
	Inspeksioni	-	-	-
43	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve komunale	50,000.00	50,000.00	-
44	Blerja e veturave zyrtare	35,000.00	20,000.00	15,000.00
	Zhvillimi i softverit për menagjim të autoparkut	Mallra e shërbime		
	Digjitalizimi i lëndës arkivore	Mallra e shërbime		
	Administrata	85,000.00	70,000.00	15,000.00
45	Furnizim me pajisje gjeodezike	12,000.00		12,000.00
	Gjeodezia	12,000.00	-	12,000.00
46	Ndërtimi dhe rindërtimi i objekteve sportive e të kulturës	80,000.00	55,000.00	25,000.00
	Kultura	80,000.00	55,000.00	25,000.00
47	Rindërtimi i objekteve shkollore dhe fushave sportive ne Komunen e Klines	210,000.00	160,000.00	50,000.00
	Furnizim me inventar ne shkolla	Mallra e shërbime	-	-
	Arsimi	210,000.00	160,000.00	50,000.00
	Totali :	4,697,012.00	3,430,012.00	1,267,000.00

Tabela 11: Përqindja sipas gjinisë

Kategoria	Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011	%
Meshkuj	19,193	49.86
Femra	19,303	50.14
Popullata e përgjithshme	38,496	100

Tabela 13.Paga dhe meditje sipas bazës gjinore

Programet	2025		
	Total Paga/Mëditje	Pagat meshkuj	Pagat femrat
Zyra e Kryetarit	150,842.13	103,390.23	47,451.91
Zyra e Kuvendit Komunal	316,117.09	153,189.28	162,927.81
Administrata dhe Personeli	341,032.00	242,263.36	98,768.64
Çështjet gjinore	8,700.00	-	8,700.00
Inspektimet	70,734.72	70,734.72	
Buxheti dhe financat	191,552.76	73,973.09	117,579.67
Infrastruktura Publike	18,529.48	18,529.48	
Zjarrfikësit dhe Inspektimet	157,000.00	157,000.00	-
Zyra Komunale për Komunitete	33,000.00	21,848.40	11,151.60
Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural	54,000.00	-	54,000.00
Kadastra dhe Gjeodezia	80,000.00	64,495.12	15,504.88
Planifikimi urban dhe mjedisi	55,000.00	37,434.51	17,565.49
Shëndetësia	1,416,970.00	707,283.26	709,686.74
Shërbimet sociale	83,878.81	55,829.08	28,049.73
Shërbimet rrezidenciale	50,000.00	30,000.00	20,000.00
Kultura, rinia dhe sporti	93,500.00	69,916.79	23,583.21
Arsimi dhe shkenca	5,771,175.00	2,937,396.94	2,833,778.06
TOTALI	8,892,032.00	4,743,284.26	4,148,747.74





DREJTORIA E ARSIMIT

01 Nr. 451-30354 /2024

Datë: 06.09 /2024

Për: Kuvendin e Komunës – Kryesuesit z. Fadil Gashi

pen Nga: Dr.sc. Qemajl Sejdija-drejtor i DKA-së

Përmes: Kryetarit të Komunës, z. Zenun Elezaj

Lënda: Propozim për caktimin e anëtarëve të komisionit për ndarje të bursave për studentet e viti akademik 2023/2024.

Drejtorja e Arsimit në seancën e muajit shtator 2024 lidhur me formimin e anëtarëve të komisionit për ndarjen e bursave për studentet e viti akademik 2023/2024, i propozon këta dy anëtarë për komision:

1. Elbarim Morina, Zyrtar i lartë i personelit në DKA
2. Nikson Daka, Drejtor në Drejtorin e Gjeodezisë, Pronës, dhe Kadastrit

Drejtorja e Arsimit me datën 28.08.2024 më kërkesë (kërkesa nr. 01-670-29058/2024), ju ka drejtuar Kryesuesit të Kuvendit Komunal, z. Fadil Gashi që në seancën e muajit shtator 2024 që të fut ne rend dite kërkesën e DKA-së për marrjen e vendimit për ndarje të bursave për studentet e viti akademik 2023/2024, dhe emërimin e këtij komisioni, andaj ne si drejtori zyrtaret e lartpërmendur i propozojmë të jen anëtar të këtij komisioni, nder sa anëtare të tjerë të komisionit i mbetet Kuvendit të i bëjë propozimet e tjera dhe formim të komisionit.

Kërkesën e bëjmë duke u mbështetur në Rregulloren për ndarjen e bursave për studentë të Komunës së Klinës, numër 01 nr.06-8132/20 te datës 04.03.2020.

Komisioni do të formohet për ndarjen e 80 bursave për studentet e Komunës së Klinës, në vlerë prej 50 euro për çdo muaj për studentet e Komunës se Klinës.

Faleminderit për ndihmesën dhe bashkëpunimin tuaj.



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-29249 /24

Klinë: 29.08 /2024

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 09.08.2024

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e VIII të rregullt për vitin 2024, shqyrtoj dhe rekomandoj për shqyrtim në Kuvend këto pika:

Pika 1. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshim-plotësim të vendimit 01Nr.06-18355/2024 për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, theksoj se mjetet të cilat kanë qenë të ri-alokuara sipas vendimit të miratuar në Kuvend janë marr nga përmbaruesi dhe në pamundësi të zbatimit të vendimit të lartcekur kërkoj që të shfuqizohet tërësisht vendimi **01Nr.06-18355/2024** i miratuar me datë **30.05.2024**, dhe të merret vendim për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (10) Në kuadër të programit Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660), nen-programi Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projektet:

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë”, kodi (54294), shuma 5,996.00 €;

“Ndërtimi i shtratit të lumit Drini i Bardhe në Kline, Volljak”, kodi (54334), shuma 32,795.47 €.

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videje-Polce-Paskalice-Jagode-Krushevë e Madhe”, kodi (54285), shuma 1,000.00 €.

Të ri-alokohen në projektet:

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Krushevë e Vogël (trotuari Kline-Zllakuqan), kodi (54341), shuma 9,763.00 €.

“Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore në Gremnik”, kodi (54292), shuma 24,000.00 €

“Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc”, (kodi 54280), shuma 6,028.47 €

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21)

Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projektet:

“Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit ne Lagjen Arberia, Tigvesh, te Sheshi Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc”, kodi (54332), shuma 4,497.00 €

Të ri-alokohen në projektet:

“Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc”, kodi (54280), shuma 4,497.00 €

Rialokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (22)

Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395), kodi funksional (0620), nga projektet:

“Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë”, kodi (52442), shuma 2,849.51 €

“Ndërtimi i parkut industrial për Klinë”, kodi (52447), shuma 9,000.00 €

Të rialokohen në projektet:

Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 11,849.51 €.

ARSYETIM: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për harmonizimin e mjetet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

Komiteti për Politik dhe Financa pas shqyrtimit të propozim -Vendimit për shfuqizimin e vendimit 01Nr.06-18355/2024 dhe propozim-vendimit për marrjen e vendimit për rialokim e mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim rekomandoj që propozimet të kalojnë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend sipas kërkesave të drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

Pika 2. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt korrik-gusht 2024,

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga H. M. I cili thekson thekson se: jeton ne kushte tejet të vështira ekonomiko-sociale dhe nuk ka asnjë burim të të ardhurave nga te cilat do mund te sigurohej mirëqenia për jetën e tij dhe te familjes.

Andaj se fundi nga fatkeqësitë natyrore më është bere dëm i larte nga Insektet, te cilat kane pushtuar e gjithë fshatin Jashanicë, insektet me kane dëmtuar pemët, perimet, gjelbërimin ne oborr, si dhe fasadën e shtëpisë, e gjithë ky dëm i shkaktuar nga insektet, te cilat dite me pare kane pushtuar fshatin Jashanicë, andaj kërkoj nga komuna e Klinës që të kompensoj demin e shkaktuar në pemëtari, perimtari dhe renovimin e fasadës së shtëpisë.

Komiteti për Politik dhe Financa pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga H.M. nga fshati Jashanicë, rekomandoj që kërkesa të dërgohet për shqyrtim tek komisioni për vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera në Komunën e Klinës.

Kërkesa 2.

Kërkesë nga banoret të cilët banojnë në objektin banesor "Rafi" për ndërtimin e dy ashensorëve ne hyrjen A he B, ne objektin afarist banesor "Raffi", ne rrugën "Abedin Rexha", perballe postes ne Kline.

Kërkojnë nga Komuna e Klinës, kryetari i komunës se klinës, si dhe kompetentet e tjerë për çështje ndërtimore qe t'i ndihmojnë financiarisht ne realizimin e ndërtimit te dy ashensorëve te jashtëm ne Objektin afaristë - banesor "Raffi" P+6 në Kline, për arsye se objekti ne fjale është një nder objektet e para te ndërtuara pas luftës ne Komunën e Klinës dhe nuk posedon ashensor. Objekti është gjashtë katesh dhe për banoret vazhdimisht krijohen probleme për lëvizjen e tyre dhe bartjen e gjërave për jetës dhe te pajisjeve te ndryshme te nevojshme për banoret e këtij objekti. Përndryshe ne objektin e tille edhe komuna e ka pjesën e vet të pronësisë afariste dhe banesore dhe ka interesin e rregullimit te ashensorëve përkatës.

Komiteti për Politik dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga banoret të cilët banojnë në objektin banesor "Raffi" rekomandoj që me rastin e hartimit dhe miratimit të buxhetit për vitin 2025 të ndahen mjete dhe të parashihet ndërtimi i liftit në objektin banesor te "Raffi".



Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 16-30838 /24

Klinë: 10.09 /2024

PËR: Kuvendin e Komunës Klinë

Nga: Komiteti për Politikë dhe Financa

Kryesuesi i Komitetit: Fadil Gashi



REKOMANDIMET e Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës: 06.09.2024

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e IX të rregullt për vitin 2024, përveç pikave të parapara në rendin e ditës, shqyrtoi dhe rekomandoi për shqyrtim dhe miratim në Kuvend këto pika:

-Propozim-vendimin e DKA-së për ndarje të bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024 si dhe formimin e komisionit për ndarje të bursave.

-Propozim-vendimin e DSHPE-së për ri-alokim të mjeteve në kuadër të kategorisë Shpenzimet Kapitale.

Pika 1. Shqyrtimi i draft-buxhetit për vitin 2025 dhe projeksionet për vitet 2026-2027

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, referoi drejtori nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim. Theksoi se buxheti për vitin 2025 është në shumë prej **16,168,653.00** euro, ndërsa projeksionet për vitet 2026 **16,878,455.00** euro dhe vitin 2027 **17,657,166.00** euro. Nga buxheti për vitin 2025, shuma prej **8,892,032.00** euro është planifikuar për paga dhe mëditje; **1,700,000.00** euro mallra dhe shërbime; **370,000.00** euro shërbime komunale; **800,000.00** euro subvencione dhe; **4,406,621.00** euro shpenzimet kapitale. Gjithashtu, kërkoi që i njëjti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-buxhetit për vitin 2025 propozoi që në kuadër të projekteve kapitale me bashkëfinancim të parashihet me buxhet ndërtimi i liftit në objektin banesor "Raffi", gjithashtu KPF-rekomandoi që draft-buxheti të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01Nr.06-20948/2024.

-Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kryesuesi theksoi se kemi një kërkesë nga Drejtoria për Financa, për shfuqizimin e vendimit 01Nr.06-20948/2024. Pasi që i njëjti nuk mund të zbatohet, pasi që me anë të përmbaruesit janë marr mjetet e bartura me këtë vendim.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01Nr.06-20948/2024, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 3. Shqyrtimi i propozim vendimit për transfer të mjeteve brenda programit Shpenzimet Kapitale

-Nga programi **Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural (470)**, nën-programi **Bujqësia-Klinë (47018)**, kodi funksional (0421) nga kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i kanaleve të ujitjes Budisalc-Jagodë-Radulloç,Poterq-Dollovë**”, kodi i projektit (54346), shuma prej 19,847.00 €.

Të transferohet në:

-Programin **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nën-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i segmenteve dhe infrastrukturës nëntokësore të rrugës “Ymer Berisha”, “Drini i Bardh”, “Skender Rexhepi”, “Abedin Rexha”, “Mehmet Haxhaj”, “Haxhi Zeka**”, kodi i projektit (54272) shuma **1,781.13** €.

-Programin **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nën-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional (0620) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300) fondi 10, projekti “**Ndërtimi i segmenteve të rrugës “Mal Bashota”, “Prek Prendi”, “Dositej Obradoviq”, “Bekim Fehmiu” dhe infrastrukturës nëntokësore në Klinë-Dresnik-Dollc**”, kodi i projektit (54280) shuma **8,175.87** €.

-Programin **Shëndetësia dhe mirëqenia sociale (730)**, nën-programin **Shërbimet e shëndetësisë primare (74050)** me kod funksional (0721) në kategorinë ekonomike Shpenzimet Kapitale (300), fondi 10, projekti “**Ndërtimi i nxehtësimit qendror me pompa termike në QKMF Klinë**”, kodi i projektit (54361), shuma 9,890.00 €.

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozim vendimit për transfer të mjeteve brenda programit Arsim dhe Shkencë.

Në kuadër të programit **Arsim dhe Shkencë (920)**, nën-programi :

Nga nën-programi Arsimi Fillor (93510), kodi funksional (0912);

-Nga kategoria ekonomike e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130), shuma 35,000.00 €;

-Nga nën-programi Arsimi i Mesëm (94710), kodi funksional (0922);

-Nga kategoria ekonomike e shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130), shuma 12,360.00 €.

Të transferohen:

Në nën-programin Administrata (92090), kodi funksional (0980);

Në kategorinë ekonomike të shpenzimeve Mallra dhe Shërbime (130) shuma 47,360.00 euro.

-Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për transfer të mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Mallra dhe Shërbime, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ri-alokim të mjeteve brenda programit Shpenzimet Kapitale.

Ri-alokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së Shpenzimeve Kapitale, burimi i financimit (10).

Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën-programi:

- Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018), kodi funksional (0451), nga projektet:

-“Blerja e kamionit me ekskavator për pastrim të ambientit në Kline”, kodi (54408), shuma 50,000.00 €;

-“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (Parqeve) Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc” kodi (5440), shuma 6,050.81 €.

Të rialokohen në projektet:

-“Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave të zeza në Zllakuqan, Jashanicë, Shtaricë, Gllarevë, Radulloc, kodi (54516), shuma 20,000.00 € ;

-“Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik, Krushevë e Vogël -Madhe, Drenoc, Qeskovë, Jashanicë , Leskoc, Ranoc”, kodi (54353), shuma 30,000.00 €;

-Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Resnik, Klinë-Videjë, kodi (54354), shuma 6,050.81 €.

Ri-alokimi i mjeteve në kuadër të kategorisë së shpenzimeve kapitale, burimi i financimit (21)

Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia (180), nën-programi:

- Infrastruktura Rrugore - Klinë (18018), kodi funksional (0451), nga projektet:

-“Blerja e kamionit me ekskavator për pastrim te ambientit në Kline”, kodi (54408), shuma 30,000.00 €;

-“Ndërtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara (Parqeve) Zajm, Caravik, Poterq, Zllakuqan, Shtupel, Jashanicë, Gllarevë, Volljakë, Budisalc” kodi (5440), shuma 20,000.00 €.

Të rialokohen në projektet:

-Rindërtimi i infrastrukturës mbitokësore me asfalt në Jashanicë, Shtupel, Resnik, Klinë-Videjë, kodi (54354), shuma 50,000.00 €.

-ARSYETIM: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për t’iu shmangur nënvlerësimit të pasurisë (ngase kamioni duhet t’i dorëzohet kompanisë së Ambientit) dhe për harmonizimin e mjetet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim vendimit për ri-alokim të mjeteve brenda programit Shpenzimet Kapitale, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për këmbim të pronës së paluajtshme

Propozim-vendim i kryetarit të Komunës së Klinës, nr. 01-463-29088/24 i datës 28.08.2024 që ka të bëjë me këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës së Klinës, me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve privat, Bujar dhe Zoje Dakaj, bashkëpronarë 1/2. Prona e paluajtshme komunale e cila jepet në emër të këmbimit pronarëve privat, Bujar dhe Zoje Dakaj është pjesa e parcelës nr.P- 71010027-01949-0 me sipërfaqe 219 m² (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror) ZK Dresnik, vendi i quajtur Përlinë e regjistruar në emër të **Pronë Shoqërore Rrugët**. Ndërsa prona private e cila merret në emër të këmbimit është pjesa e parcelës kadastrale, nr. P-71010027-02246-0 ZK Dresnik, me sipërfaqe 219 m² (dyqind e nëntëmbëdhjetë metra katror), vendi i quajtur Përlinë, livadhi pa vadë, e regjistruar në emër të pronarëve privat, Bujar dhe Zoje Dakaj, bashkëpronarë 1/2.

-Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme është realizimi i planit rregullues për realizimin e qëllimit të ligjshëm publik, realizimi i projektit rregullim i trotuarit dhe shtegut të biçikletave dhe zgjerimi i kryqëzimit të rrugës.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për këmbimin e pronave të paluajtshme me qëllim të realizimit të projekteve infrastrukturore, rekomandoi që propozim-vendimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 7. Shqyrtimi i propozim vendimit të DKA-së për ndarje të bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024 dhe formimin e komisionit për ndarje të bursave.

Kryesuesi i KPF-së theksoi se propozim-vendimi i DKA-së i cili ka arritur përmes zyrës së kryetarit ka për qëllim marrjen e vendimit në Kuvend ashtu siç parashihet me rregulloren komunale për ndarje të bursave. Po ashtu, kërkohet themelimi i komisionit për ndarje të bursave për studentë ku parashihen të ndahen 80 bursa për vitin akademik 2023-2024.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimit për ndarje të bursave për studentë për vitin akademik 2023-2024 dhe formimin e komisionit për ndarje të bursave, rekomandoi që propozimi të kalojë për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika 8. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajt gusht-shtator 2024.

Kërkesa 1.

Kërkesë e parashtruar nga znj. Nazife Gucati e cila thekson se jeton në gjendje të rënd financiare, është viktimë e dhunës së familje dhe se nuk ka strehim të përhershëm por jeton me qira. Andaj kërkon subvencionim të qirasë për vitin 2024 në shumë nga 2000 deri në 2500 euro për mbulimin e qirasë vjetore.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimi të kërkesës së parashtruar nga znj. Nazife Gucati për subvencionim të qirasë vjetore për vitin 2024, rekomandoi që kërkesa të kalojë për shqyrtim në Kuvend.

Kërkesa 2.

Kërkesë e parashtruar nga Rrustem Berisha i cili thekson se jeton në një gjendje të rënd ekonomike i pa punë, me një familje 5 anëtarëshe dhe pa pronë të trashëguar. Kohë më parë, vajza është diagnostikuar me Tumor në stomak dhe si rezultat i kësaj është dashur t'i nënshtrohet operimit i cili ka kushtuar gjithsej 11,900.00 euro, shumë e cila është huazuar nga familjarët. Po ashtu, sëmundja kërkon trajtim dhe vizita të herëpashershme. Andaj kërkon nga Institucionet në Komunën e Klinës që t'i dalin në ndihmë me rastin e kthimit të huazimit të mjeteve financiare lidhur me rastin e lartpërmendur.

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga Rrustem Berisha për mbështetje financiare, rekomandoi që kërkesa të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit.



Kuvendi i Komunës Klinë

01 Nr prot. 06-18355/2024

Datë: 05.06/2024

Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 20.05.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 30.05.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi -300), fondi burimor 10, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22.
2. **Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) fondi burimor 10.**
 - 2.1 Brenda kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi 10, në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nen-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional **(0620)**
 - 2.2 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë” (kodi 54294), shuma **5,996.00 €**;
 - 2.3 Nga projekti “Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Klinë, Volljak” (kodi 54334), shuma **7,495.00 €**.
 - 2.4 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe” (kodi 54285), shuma **9,400.00 €**
 - 2.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **22,891.00 €**
Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

3. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21

3.1 Nga projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujës-jellës në Lagjen Arberia, Tigvesh, te Sheshi Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc” (kodi 54332), shuma 4,497.00 €

3.2 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 4,497.00 €, **Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

4. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22

4.1 Nga projekti “Ndërtimi i shtigjëve të ecjës dhe infrastruktura rrugore në Gryken e Jarinës - Pogradjë” (kodi 52443), shuma 15,276.50 €

4.2 Nga projekti “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë” (kodi 52442), shuma 2,849.51 €

4.3 Nga projekti “Ndërtimi i parkut industrial për Klinë” (kodi 52447), shuma 30,000.00 €

4.4 Nga projekti “Ndërtimi me gure i sheshit "Muje Krasniqi" në Kline” (kodi 54004), shuma 1,250.80 €

4.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 49,376.81 €.

Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**